



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr-016-58451

Më datë 10.10.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 14/2019”, e në zbatim të nenit 3, lidhur me nenin 4, të Rregullores (QRK) Nr. 23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat MultiDisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për Themelimin e Tryezës MultiDisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit**

1. Themelohet Tryeza MultiDisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit në Komunën e Suharekës.
2. Tryeza MultiDisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit, ka këtë përbërje:
  - 2.1. Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale,
  - 2.2. Ndihmës menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale,
  - 2.3. Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë të Viktimave –Mbrojtësi i Viktimave.
  - 2.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës-Zyrtari i Shërbimit Sprovues,
  - 2.5. Qendra e Mjekësisë Familjare –mjek specialistë sipas specifikave të rastit,
  - 2.6. Policia e Kosovës,
  - 2.7. Qendra e Shëndetit Mendor-specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve,
  - 2.8. Drejtoria e Arsimit-Zyrtar për Arsim,
  - 2.9. Drejtoria për shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-zyrtari përgjegjës,
  - 2.10. Psikologu/punëtori social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësuesi i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor,
  - 2.11. Zyra për Komunitete dhe Kthim-zyrtari për komunitete,
  - 2.12. Institucioni për Strehim Përkujdesës ose Familje Strehuese,
  - 2.13. Zyra për të Drejtat e Njeriut-zyrtari për të drejtat e njeriut/fëmijës,
  - 2.14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës.
3. Tryeza Multidisiplinare udhëhiqet nga Menaxheri i rastit, i cili është zyrtar i shërbimeve sociale i caktuar nga Qendra për Punë Sociale (në tekstin e mëtejme: QPS) dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 3.1. Të trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pasdore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;
  - 3.2. Të përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke plotësuar me informata të

përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast;

- 3.3. Të bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
- 3.4. Të koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;
- 3.5. Të rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh;
- 3.6. Të harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

**Bali MUHARREMAJ**

- Vendimi iu dërgohet:
- QPS-s
- Anëtarëve,
- Arkivës së Kryetarit.